

V E N D I M
Nr.136, datë 7.3.2003

PËR SHPËRNDARJEN E TEKSTEVE SHKOLLORE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 56 e 63 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin e arsimit parauniversitar”, ndryshuar me ligjin nr.8387, datë 30.7.1998 dhe të nenit 8 të ligjit nr.8983, datë 20.12.2002 “Për Buxhetin e Shtetit, të vitit 2003”, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Marrjen në përdorim falas në bibliotekën e shkollës, duke filluar nga viti shkollor 2003-2004, të teksteve shkollore nga të gjithë nxënësit e arsimit të detyruar, me detyrimin që t’i dorëzojnë në fund të vitit mësimor.

2. Këto tekste, që janë pronë e Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës, të përdoren për një periudhë deri në tre vjet.

3. Kostoja e plotë e botimit, shtypjes dhe shpërndarjes së teksteve, për vitin 2003, të mbulohet nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe të Shkencës, nga subvencioni i parashikuar për këto tekste dhe nga fondet e dhëna nga Banka Botërore, për projektin “Reforma në arsim I”, kredia nr.3343-ALB.

4. Zhdëmtimi për tekstet e humbura dhe të papërdorshme të bëhet nga përdoruesi në masën e koston së plotë, duke zbritur 25 për qind të vlerës fillestare për çdo vit përdorimi.

5. Fletoret e punës për nxënësit e arsimit të detyruar, që nuk përdoren më shumë se një vit shkollor dhe tekstet shkollore të arsimit të mesëm, të subvencionohen nga shteti dhe të blihen nga nxënësit, me çmimin e përcaktuar në udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës dhe të Ministrisë së Financave.

6. Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, me fondet e saj buxhetore vjetore, të hartojë dhe zbatojë skemën e re për subvencionimin e teksteve shkollore.

7. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe e Shkencës dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi dhe për nxjerrjen e akteve të nevojshme nënligjore.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

SKEMA E BOTIMIT DHE SHTYPJES SË TEKSTEVE SHKOLLORE PËR NXËNËSIT E ARSIMIT TË DETYRUAR NË VITET 2003-2015

Skemë me ripërdorim cikli 3-vjeçar

Plan në vite	Viti shkollor	Klasa I	KlasaII	Klasa III	Klasa IV	Klasa V	Klasa VI	Klasa VII	Klasa VIII	Vërejtje
1	2003-2004	B.Mash	B.MASH	B.MASH SH.BB	B.MASH Sh.BB.	B.MASH SH.BB	B.MASH	B.MASH SH.BB	B.MASH SH.BB	F.Pune Botuesi
2	2004-2005	Konkurs MASH Kurrikula Të reja	Ripërdorim	Ripërdorim	Ripërdorim	Ripërdorim	Konkurs MASH Kurrikula Të reja	Ripërdorim	Ripërdorim	F.Pune Botuesi
3	2005-2006	Ripërdorim	Konkurs MASH Kurrikula Të reja	Ripërdorim	Ripërdorim	Ripërdorim	Ripërdorim	Konkurs MASH Kurrikula Të reja	Ripërdorim	F.Pune Botuesi
4	2006-2007	Ripërdorim	Ripërdorim	Konkurs MASH Kurrikula Të reja	Rishtypje MASH	Rishtypje MASH	Ripërdorim	Ripërdorim	Konkurs MASH Kurrikula Të reja	F.Pune Botuesi
5	2007-2008	Rishtypje	Ripërdorim	Ripërdorim	Konkurs MASH Kurrikula Të reja	Ripërdorim	Rishtypje MASH	Ripërdorim	Ripërdorim	Konkurs MASH Kurrikula
6	2009-2010	Ripërdorim	Rishtypje MASH	Ripërdorim	Ripërdorim	Konkurs MASH Kurrikula Të reja	Ripërdorim	Rishtypje MASH	Ripërdorim	Ripërdorim
7	2011-2012	Ripërdorim	Ripërdorim	Rishtypje MASH	Ripërdorim	Ripërdorim	Ripërdorim	Ripërdorim	Rishtypje MASH	Ripërdorim
8	2012-2013	Rishtypje MASH	Ripërdorim	Ripërdorimi	Rishtypje MASH	Ripërdorim	Rishtypje MASH	Ripërdorim	Ripërdorim	Rishtypje MASH
9	2013-2014	Ripërdorim	Rishtypje MASH	Ripërdorim	Ripërdorim	Rishtypje MASH	Ripërdorim	Rishtypje MASH	Ripërdorim	Ripërdorim

10	2014- 2015	Ripërdorim	Ripërdorim	Rishtypje MASH	Ripërdorim	Ripërdorim	Ripërdorim	Ripërdorim	Rishtypje MASH	Ripërdorim
----	---------------	------------	------------	-------------------	------------	------------	------------	------------	-------------------	------------